

FOG



MJEGULL / FOG

Kuruar nga /curated by:
Avi Lubin

Artistët pjesëmarrës / Participating artists:
Albert Allgaier/ Driton Selmani/ Fatmir Mustafa-Karillo/ Gazmend Ejupi/Luan Bajraktari

Kohëzgjatja e ekspozitës / Exhibition dates:
17.05.2018-17.06.2018

Katalogu-Catalogue

Botues / publisher:
Galeria Kombëtare e Kosovës / National Gallery of Kosovo

Teksti / text:
Avi Lubin

Fotografitë / Images:
Enver Bylykbashi

Përkthimi dhe lektura / Translation and proofreading:
Jehona Xhaferi

Dizajni / Design:
TREMBELAT

Shtypi / Print
VIPRINT

Viti / Year: 2018

Ekspozita dhe katalogu janë realizuar me mbështetje Nga Ministria e Kulturës,
Rinisë dhe Sporteve / The Exhibition And Catalogue Are Supported by the
Ministry of Culture, Youth and Sports.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës-Vlada Kosova-Government of Kosovo
MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT

Sponzorë Medial / Media Sponsors:



Stafi i Galerisë Kombëtare të Kosovës- National Gallery of Kosovo staff:
Arta Agani, Drejtoreshë -Director; Zeni Ballazhi, Kurator-Curator; Mexhide Maxhuni, Zyrtare për financa -Finance officer; Lirije Buliqi, Zyrtare e lartë administrative -Senior administrative officer; Naim Spahiu, Koordinator për ekspozita -Coordinator for exhibitions; Enver Bylykbashi, Fotograf profesional -Professional photographer; Skender Xhukolli, Teknik për ekspozita -Exhibition technician; Rrahman Bislmi, Teknik për ekspozita/Mirëmbajtës i objektit -Exhibition technician /Building caretaker; Xhevat Rrahimi, Kujdestar i sallës ekspozuese -Exhibition hall attendant; Valdet Sylja & Mentor Abdullahu, roje nate -security guards

MJEGULL FOG



Mjegulla

Nga Avi Lubin

Herën e parë kur u ftova ta vizitoj Kosovën, në janar të vitit 2018, ishte e pamundur të aterohej në Prishtinë për shkak të mjegullës. Kjo u përshtat shumë mirë me shakanë që e kisha për Kosovën: se ajo nuk ekziston. E gjitha kjo filloi kur kuptova se Izraeli nuk e njeh sovranitetin e Kosovës. Çka do të thotë të jesh shtet pjesërisht i njohur, siç është Kosova? Çka do të thotë të jesh territor i kontestueshëm?

Sugjerova ta kuroj një ekspozitë e cila nuk ekziston, me artistë që nuk ekzistojnë, në një galeri e cila nuk ekziston. Çuditërisht e pash një vepër më të mocme të Driton Selmanit, të titulluar Më Trego Prej nga Jam? (2012). Përderisa Selmani ishte duke qëndruar në një program rezidencial në MB, ai kërkoi nga nëntë rezidentë tjerë, artistë nga pjesë të ndryshme të botës (Brazil, Polonia, Portugalia, Japonia, Qiproja, Irlanda dhe MB) ta vizitojnë hartën e Kosovës dhe vendndodhjen e saj në hartën e botës. Përgjigjet ishin larg nga realiteti, duke përfshirë edhe atë i cili mendoi se Kosova është Ishull dhe një tjetër që e emëroi shtetin Kosobo. Përkrah këtyre nëntë hartave të ndryshme të vizatuara nga rezidentët, nëna e Selmanit, me kërkesë të tij, kishte përdorur Qëndisjen me gjilpërë në material për ta krijuar imazhin e hartës së botës në të cilin Kosova mungon, si një vrimë në glob.

E megjithatë metafora e “një ekspozite që nuk ekziston me artistë që nuk ekzistojnë në një shtet që nuk ekziston” kërkoi që të hapet një sferë e imagjinatës politike ku çdo gjë është e mundur dhe çdo gjë mund të ndodhë, ku njeriu nuk ka nevojë t’i bindet asnjë rregulli apo kategorie të realitetit, madje as gravitetit! Ajo kërkoi të mendohet për galerinë kombëtare të Kosovës si një jo-vend apo një ish-territor, një sferë imagjinare që ekziston përtej radarit dhe mund të hapë këndvështrime të reja, mënyra të reja të veprimit në realitetin tonë të mjegullt.

Në hyrje të galerisë, Albert Allgaier krijoi Kafenenë Hard Rock Pjong Jang (2018) - një shitore suveniresh me gjëra si gota, pulla dhe maica me logon e kësaj dege fiktive nga Koreja Veriore të zinxhirit me këtë temë të restoranteve ndërkombëtare. Përfytyrimi i një “Kafeneje Hard Rock” në kryeqytetin e Koresë Veriore krijoi një kalim në mes të pjesës së jashtme dhe të brendshme të galerisë dhe u bë një lloj tampon zone në mes të botës reale dhe “jo hapësirës” apo “ish-territorit” të cilin u mundua ta ofronte galeria. Kjo “Poezi shumë konkrete”, term të cilin Allgaier e përdor për të folur për praktikën e tij, kërkoi nga vizitorët të harrojnë atë që dinë dhe t’i injorojnë paragjykimet e tyre paraprake. Ajo funksionon si përzierje e të ardhmes së imagjinuar Utopiane, kritikës ndaj mungesës

së imagjinatës në perëndim dhe shakasë.

Duket se në periudhën e stresit gjeopolitik, frustrimit me momentin politik momental dhe jostabilitetin, kur nuk e din çka të presësh dhe si të sillesh, nuk është e lehtë të shkëputesh nga e kaluara dhe të hysh në sferën e imagjinatës politike, sidomos kur e kaluara është traumatike si në Kosovë.

Filmat e Gazmend Ejupit, Humbja Momentale e Arsyës 1 (2003), dhe Humbja Momentale e Arsyës 2 (2017), kanë të bëjnë me raportet në mes të historisë kolektive të Kosovës dhe biografisë së tij. Ato janë pjesë e një projekti në vazhdimësi në të cilin artisti e dokumenton familjen e tij përdërisa e kaluara dhe e tashmja e Kosovës janë në prapavijë. Filmi i parë është xhiruar në vitin 2001 kur Ejupi është kthyer në Kosovë nga Londra për herë të parë pas luftës. Ai filloi ti xhirojë prindërit e tij në kuzhinën e banesës së tyre, së bashku me tri motrat e tij dhe kushëririn duke qëndruar në errësirë për shkak të ndërprerjeve të energjisë elektrike. Ejupi e drejton kamerën në llambën e tavolinës që është pranë babait të tij. Biseda përqendrohet në jetën e përditshme, në ushqim apo në çështjen se si ndërprerja e energjisë elektrike mund ta dëmtojë televizorin. Ata po pëshpëritin - shprehi nga koha e luftës. Askush nuk flet për konfliktin dhe duket se errësira e shkaktuar nga ndërprerja e energjisë elektrike është normale, si një lloj rutine. Shumica e filmit ndodh në errësirë. Kohë pas kohe energjia elektrike kthehet për një moment të shkurtër dhe pastaj ndërpritet sërish. Ai përfundon kur kthehen dritat.

Pothuaj se dy dekada më vonë Ejupi e xhiron Humbja Momentale e Arsyës 2, ku fokusohet në një shtëpi me tulla dheu që e kishte ndërtuar gjyshja e tij. Tullat janë përdorur disa vite më parë në një vepër tjetër - një instalacion të cilin Ejupi e kishte titulluar Toka ku Qëndroj. Filmi fokusohet në një zjarr ku familja është duke djegur mobilet e mbetura dhe rroba të vjetra, ndërsa shtëpia e vjetër dhe e rrënuar gjendet në prapavijë.

Dëshmitari i Fundit (2018) i Fatmir Mustafa -Karllos gjithashtu merret me historinë e fundit të Kosovës - dhunën dhe Mizorinë që e ka përjetuar gjatë konfliktit dhe pas tij. Në qendër të veprës së tij qëndron një tabut i vjetër prej druri, i vendosur në pozitë vertikale. Fatmir - Karlo e ka marrë atë nga një xhami vendore 15 vjeçare, "Xh. Fusha e Pajtimit", dhe e ka blerë një të re për ta zëvendësuar. Ky tabut është përdorur për varrosjen e shumë njerëzve në Kosovën e pas luftës, duke përfshirë disa vdekje të dyshimta në lidhje me luftën. Ai e ka vendosur një skulpturë brenda në tabut - një siluetë të njeriut të mbuluar me një çarçaf

të bardhë. Ky dëshmitar fantazmë e sjell një lloj të ri të dëshmisë që nuk shikon nga e tashmja kah e kaluara, por e sjell si objekt në të tashmen.

Vëllau i Milotit e Luan Bajraktarit korrespondon me një skulpturë të mëparshme të artistit, Miloti, e cila gjithashtu është prezantuar në Galerinë Kombëtare të Kosovës disa vite më parë. Ndryshe nga Miloti, që ishte punuar nga bronzi, skulptura momentale e Bajraktarit është e punuar nga gipsi, dhe kështu jo vetëm që e sfidon kuptimin e momenteve por edhe mundëson që djali të jetë në të njëjtën kohë akuzues, spektator dhe dëshmitar.

Në veprën tij të re YOU-GO (2018) Gazmend Ejupi mori një veturë familjare “Yugo”, e preu pjesën e përparme dhe e instaloi sikur të jetë përplasur në dyshemenë e galerisë. Yugo-ja, makinë me motor në pjesën e përparme, që tërheq me rrotat e përparme, është prodhuar nga një korporatë jugosllave. Në brendi të veturës, Ejupi e instaloi një altoparlant që transmeton një intervistë me pronarin e mëparshëm, i cili tregon se si ai dhe familja e tij katër anëtarëshe e kishin bërë veturën shtëpi të tyre për tetë ditë gjatë luftës. Ejupi e vari në mur një kopje të librezës së veturës, duke theksuar se tregimi historik kolektiv përbëhet nga tregimet personale. Ai arriti ta portretizojë veturën si një nga objektet më ikonike dhe si përkujtues të asaj që ka mbetur nga ish-Jugosllavia. Në të njëjtën kohë ai e transformoi veturën konkrete të mbushur me biografi personale të pronarit, në një objekt arti.

Por kjo veturë ta përkujton veturën e famshme nga historia e artit bashkëkohor - Mbyti Veturat të Gustav Metzger-it nga viti 1996. Vetura e Metzger-it ishte e parkuar jashtë Galerisë Serpentine në Londër, ku teknikët vendorë përdorën çekanë për ta goditur deri sa e bënë të dukej si një gëzhojë e shtypur në një fotografi lajmesh të një demonstrate në rrugë të cilën Metzger e kishte parë në Camden Town. Në fotografi, dy fëmijë qëndrojnë në kulmin e një veture të shkatërruar. Ata bërtisnin, ‘Mbyte veturën, mbyte veturën!’, deri sa u dërmuan. Metzger e zhvilloi konceptin e Artit Auto-Desruktiv (Auto-Destructive Art, ADA), duke i marrë objektet nga jeta e përditshme dhe duke shkaktuar dëm. Pas Luftës së Dytë Botërore, ai përmes artit të tij deshi të paraqesë shkatërrimin e krijuar nga lufta. Arti Auto-Destruktiv kërkoi tërheqje nga prodhimi në masë, komercializmi dhe prodhimtaria. Metzger madje deklaroi në manifeston e tij se “Arti auto-destruktiv e reflekton perfeksionizmin e sëmurë të prodhimit të armëve - shkëlqim deri në pikën shkatërruese.”

Një veturë tjetër në këtë ekspozitë është Pamja (2018), një vepër nga Fat-

mir Mustafa - Karlo, e cila është e instaluar jashtë galerisë. Artisti e ka vendosur një veturë të bardhë (“Golf”) në barin afër hyrjes së ndërtesës. Tymi që del nga auspuhi i veturës kthehet në pjesën e brendshme të veturës përmes një tubi të ndërtuar nga artisti, që e mbush veturën me tym duke e kthyer atë në makinë vrasëse apo makinë vdekje. Ky imazh i Veturës Gjermane që mbushet me gaz është një imazh shumë i fuqishëm për ta filluar ekspozitën.

Megjithatë duket se mjegulla dhe tymi që e rrethojnë këtë ekspozitë kërkojnë të mendosh për potencialin që ka realiteti i mjegullt dhe të reflektosh për faktin se mungesa e qartësisë mund të krijojë shtigje të reja të të pamurit.

Të Gjalla dhe të Ziera e Driton Selmanit (2018), një skulpturë e cila i bën së bashku telin me gjemba dhe dorëzat e boksit, e ka titullin e huazuar nga një ese i rëndësishëm i antropologut dhe filozofit Claude Lévi-Strauss. Në hyrjen e mirënjohur të këtij libri Lévi-Strauss shkruan se “disa kategori të kundërta të marra nga përvoja e përditshme me gjërat më themelore – p.sh. ‘të gjalla’ dhe ‘të ziera’, ‘të freskëta’ dhe ‘të kalbura’, ‘të lagështa’ dhe ‘të thata’ e të tjera – mund tu shërbejnë njerëzve si mjete konceptuale për formimin e nocioneve abstrakte dhe për kombinimin e tyre në sugjerime të reja”. Selmani, përmes një lëvizje të ngjashme, edhe pse në proporcion më të vogël, paraqet gjithashtu veprën E pati-tutlluar (2018) – një skulpturë e vogël që përbëhet nga një thikë shumë e madhe, e bërë me kërkesë të artistit në teknikë tradicionale dhe një gomë fshirëse të madhe në anën tjetër, duke i vënë në një sipërfaqe tri ide të ndërlidhura: bërjen, fshirjen dhe ribërjen.

Loja e Luan Bajraktarit (2018) është një fushë futbollit me tre gola të bardhë, barin e gjelbër të vizatuar me linja të bardha që i ngjajnë atyre të fushës së futbollit, një lloj reflektimi apo metafore e konflikteve. Në anën tjetër, Bajraktari pyet si mund të bëhen konfliktet politike në mes të dy palëve nëse palët e konfrontojnë njëra-tjetrën në mënyrë të drejtpërdrejtë pa ndërmjetësues dhe palë të trete, si në një lojë sporti. Në anën tjetër, kjo e ngrit çështjen e kundërt në lidhje me aftësinë për ta propozuar këndvështrimin e tretë, ndoshta një mënyrë e mesme që mund ta thyejë binaren e konflikteve mes dy palëve.

Punë e Rëndë (2017) është një skulpturë e një kufome/pastrehuari të shtrirë në dysheme, një shtëpi e vogël e bërë nga qyrrat që gjendet në gishtin e saj. Ky projekt ishte proces dy vjeçar i jetesës si i pastrehë në Helsinki, duke eksploruar materiale të reja dhe duke ëndërruar një shtëpi. Fatmir-Karlo në disertacionin e tij të hartuar për studimet e tija MFA, shkruan në lidhje me projektin:

“E kam përdorur batanijen time si dëshmi, dorën time si bazë dhe qyrat si material”.

Gjatësia Mesatare e një Numri Arbitrar të Njerëzve në një Moment të Caktuar në Kohë dhe Hapësirë e Albert Allgaier-it (2018) përbëhet nga pesë vija të ngjyrave të ndryshme të ngjitura në mur. Secila vijë përfaqëson gjatësinë mesatare të një grupi arbitrar të njerëzve, duke përfshirë popullatën e gjinisë femërore të Republikës së Kosovës (Regjistrimi 2017), popullatën e gjinisë mashkullore të Republikës së Kosovës (Regjistrimi 2017), njerëzit e përfshirë në ekspozitën Mjegulla në Galerinë Kombëtare të Kosovës, anëtarët e bendit “The Spice Girls” dhe anëtarët e ekuipazhit të misionit në hapësirë “Apollo 13”. Allgaier-i i përzien statistikën zyrtare dhe të dhënat fiktive, duke vënë dyshime në këtë mënyrë në bazën e të dhënave ‘objektive’ dhe duke luajtur me tendencën e njerëzve për ta krahasuar veten me statistika.

Një vepër tjetër e Selmanit është Bashkimi i Patitulluar (2012) – një flamur i kuq i cili në fakt është një kolazh i materialeve të tekstilit të prera nga flamuj të vendeve të ish-Jugosllavisë. Ky flamur i madh i kuq jo vetëm që e sfidon raportin në mes të koncepteve të identitetit dhe përkatësisë, por edhe vë theksin në kuptimin e ngjyrave në kuadër të kujtesës kolektive.

Vrima është në Kokën Tënde e Albert Allgaier-it (2016) ishte rezultat i dy periudhave gjatë të cilave ai qëndroi si rezident në Koloninë e Artit Nida të Akademisë së Arteve Vilnius (në vitin 2014 dhe 2016). Allgaier-i krijoi një fushë golfi, por pa asnjë vrimë. Gjatë intervistës që e dha para kuratores Sophie Lapalu, Allgaier shpjegon: “Mendoj se golfi dhe fushat e golfit janë simbole të kohës tonë. Një mënyrë për ta privatizuar tokën. Më pëlqen tregimi se si Kastro dhe Gevara luajtën një lojë golfi për ta përqeshur Ajzenhauerin. Kur shkova për herë të parë në Jokohama në Japoni e kontrollova adresën time në google maps dhe pash shumë hapësirë të gjelbër dhe mendova, uau sa shumë parqe. Pasi shkova atje e pash se shumica nga to ishin fusha golfi. Isha me të vërtetë i zhgënjyer... Projekti ishte disi për ta çliruar këtë veprim të thjeshtë, goditjen e topit me një shkop, nga e gjithë barra e vet simbolike, ri-instalimi i lirisë së individit për ta marrë ose jo një gjë si serioze.”

Fog

By Avi Lubin

When I was first invited to visit Kosovo, in January 2018, the plane could not land because of the thick fog. This set well with the joke I had for Kosovo - that it does not exist – which began when I found out that Israel does not recognize the sovereignty of Kosovo. What does it mean to be a partially recognized state as Kosovo is? What does it mean to be a territory under dispute?

I suggested to curate an exhibition that doesn't exist, with artists that do not exist, in a gallery that doesn't exist. Funny enough I saw an older work by Driton Selmani, titled Tell me Where I am From? (2012). The work was made while Selmani was staying in a residency program in the UK where he asked nine of the residents, artists from different places in the world (Brazil, Poland, Portugal, Japan, Cyprus, Ireland and the UK), to draw a map of Kosovo and its location in the world map. The answers were far from reality, including one that thought that Kosovo was an Island and another that named the state Kosobo. Alongside the nine different maps that the residents drew, Selmani's mom used, at his request, a needle embroidery on fabric to create an image of the world's map where Kosovo is missing, like a hole in the globe.

Yet the metaphor of “an exhibition that doesn't exist, with artists that do not exist, in a state that does not exist” asked to open a sphere of political imagination where anything is possible and anything can happen. Where one does not have to obey any rule or category of reality, not even gravity! It asked to think about the National Gallery of Kosovo as a non-place or an ex-territory, a hallucinatory sphere that exists outside of the radar and can open new points of view and new ways of acting in our ambiguous reality.

At the entrance to the gallery, Albert Allgaier created Hard Rock Cafe Pyöng Yang (2018) - a souvenir shop with merchandise like mugs, buttons and t-shirts with the logo of this fictitious North Korean branch of the international theme restaurant chain. The envision of a “Hard Rock Café” in the North Korean capital created a passage between the outside and the inside of the gallery and became a kind of a buffer zone between the real world and the “non-space” or “ex-territory” that the gallery tried to offer. This “Very concrete poetry”, a term Allgaier uses to talk about his practice, asked the visitors to forget what they know, and ignore their previous biases. It functions as a mixture of a Utopian imagined future, as criticism on the lack of imagination in the west, and as a joke.

It seems that in a time of geopolitical stress, frustrations of the current

political moment, and the resulting instability, one does not know what to expect and how to behave. It is not easy to detach the past and enter a sphere of political imagination, especially when the past is traumatic like in Kosovo.

Gazmend Ejupi's films *Momentary Lapse of Reason 1* (2003), and *Momentary Lapse of Reason 2* (2017), are dealing with the relations between the collective history of Kosovo and his own biography. They are part of an ongoing project in which the artist documents his family while Kosovo's past and present are in the background. The first film was shot in 2001 when Ejupi came back to Kosovo from London for the first time after the war. He started filming his parents in their apartment's kitchen, sitting in darkness caused by power cuts, together with his three sisters and cousin. Ejupi is pointing the camera at a table lamp next to his dad. The conversation focuses on the everyday life, on food, or the question of how power cuts can brake televisions. They are whispering – a habit from the war days. No one is talking about the conflict and it seems that the darkness caused by the power cuts is normal, like a routine. Most of the film happens in darkness. Every now and then the electricity is back on for a short moment and then it is out again. It ends when the lights are back on. Almost two decades later Ejupi filmed *Momentary Lapse of Reason 2*, focusing on a mud brick house that was built by his grandmother. The bricks were used a few years ago in another work - an installation that Ejupi titled *The Ground on Which I Stand*. The film is focusing on a bon-fire where the family is burning the remaining furniture and old clothes, and the old and dilapidated house is in the background.

Fatmir Mustafa –Karlo's *The Last Witness* (2018) is also dealing with the recent history of Kosovo - the violence and the atrocities that were suffered during the conflict and remain since. In the center of the work stands an old wooden coffin, installed vertically. Fatmir-Karlo received it from the 15 years old local mosque, "Xh. Fusha e Pajtimit", and bought a new one to replace it. This coffin was used for the burials of lots of people in post-war Kosovo, representing some suspicious deaths related to the war. Inside the coffin, he placed a sculpture – a silhouette of a human covered with a white sheet. This ghostly witness is bringing a new kind of testimony that is not looking at the past from the present, but rather bringing it to the present as an object.

Luan Bajraktari's *Vëllau i Milotit* (Milot's Brother) corresponds with a previous sculpture by the artist, Milot, that was also shown at the National Gallery

of Kosovo a few years ago. Unlike Milot that was made of bronze, Bajraktari's current sculpture is made of gypsum, and thus not only challenges the conception of monuments but also enables the boy to be at one and the same time an accuser, a spectator and a witness.

In his new work *YOU-GO* (2018) Gazmend Ejupi took a "Yugo" family car, cut its front and installed it as if the car was crushed into the gallery's floor. Yugo, a front-engine, front-wheel drive automobile, was manufactured by a Yugoslav corporation. Inside the car Ejupi installed a speaker that plays an interview with the previous owner, telling the story of how he and his family of four made the vehicle their home for eight days during the war. On the wall Ejupi hung a copy of the car's logbook, emphasizing that the historical collective story is composed of personal stories. He succeeded in portraying the car as one of the most iconic objects and a reminder of what is left from ex-Yugoslavia. At the same time, he transforms the concrete car loaded with the owner's personal biography, into an object of art.

But this car also puts in mind a very famous car from the history of contemporary art - Gustav Metzger's *Kill the Cars* from 1996. Metzger's car has been parked inside the Serpentine Gallery in London, where local technicians used sledgehammers to pound it until it resembled a crushed husk in a news photograph of a street demonstration Metzger once witnessed in Camden Town. In the photograph, two kids are standing on the roof of the smashed car. They were shouting, 'Kill the car, kill the car!', until they were exhausted. Metzger developed the concept of Auto-Destructive Art (ADA) by taking everyday objects and causing damage. After World War II, he wanted to showcase the destruction created from the war through his artwork. Auto-Destructive Art asked to withdraw from mass production, commercialism, and manufacturing. Metzger even stated in his manifesto that "Auto-destructive art mirrors the compulsive perfectionism of arms manufacture - polishing to destruction point."

Another car in this exhibition is *The View* (2018), a work by Fatmir Mustafa -Karlo, which is installed outside the gallery. The artist placed a white car, a Volkswagen Golf, on the lawn near the entrance to the building. The smoke that is coming out from the car's exhaust returns to the inner part of the car through a pipeline built by the artist, filling the car with smoke and turning it into a killing machine or a death machine. This image of a German Car filling with gas is a very strong image to begin the exhibition. The smoke, like the fog that prevent-

ed the airplane from landing, remain infused throughout. It serves as an invitation to think about the potential this misty reality has, and to reflect on the fact that lack of clarity can create new pathways for seeing.

Driton Selmani's *The Raw and the Cooked* (2018), a sculpture that puts together a barbed wire and red boxing gloves, borrows its title from an important essay by anthropologist and philosopher Claude Lévi-Strauss. In the well-known introduction to this book, Lévi-Strauss writes that "certain categorical opposites drawn from everyday experience with the most basic sorts of things — e.g. 'raw' and 'cooked,' 'fresh' and 'rotten,' 'moist' and 'parched,' and others — can serve a people as conceptual tools for the formation of abstract notions and for combining these into propositions." In a similar move, though in smaller scale, Selmani also shows *Untitled* (2018) – a small sculpture that is composed of a very large knife, made on the artist's request in traditional techniques and a huge eraser on the other end, thus putting on the surface three related ideas: doing, undoing and redoing.

Luan Bajraktari's *Loja* (2018) is a soccer field with three white goals, green grass drawn with white lines that resemble those of a soccer field, which serves as a kind of reflection or metaphor on conflicts. On the one hand, Bajraktari asks how political conflicts between two sides could be conducted if the sides confronted each other directly without mediators and third parties, like a sports game. On the other hand, it raises the opposite question about the ability to propose a third view, maybe a middle way that can break the binary of two-sided conflicts.

Hard Working (2017) is a sculpture of a homeless/corpse lying on the floor, a small house made of snot on its finger. This project by Fatmir Mustafa-Karillo was conceived over a two-year process while living homeless in Helsinki, exploring new materials and dreaming a house. In his MFA thesis Karillo writes about this project: "I used my blanket as evidence, my hand as a base and the snot as a material".

Albert Allgaier's *The Average Height of an Arbitrary Number of People at a Given Moment in Time and Space* (2018) is composed of five different colored lines taped onto the wall. Each line is representing the average height of an arbitrary group of people, including the female population of The Republic of Kosovo (Census 2017), the male population of The Republic of Kosovo (Census 2017), the people involved in the exhibition *Fog* at The National Gallery of Kosovo,

members of the band “The Spice Girls” and crew members of the space mission “Apollo 13”. Allgaier mixes official statistics and fictive data, thus implanting bugs in the “objective” database and playing with the tendency of people to compare themselves to the statistics.

Another work by Driton Selmani is *Untitled Union* (2012) – a red flag which is in fact a collage textile cut of flags from ex-Yugoslavia countries. This huge red flag is not only challenging the relations between the concepts of identity and belonging, but also points on the meaning of colors within collective memory.

Albert Allgaier’s *The Hole is in Your Head* (2016) was an outcome of two periods he spent as a resident at Nida Art Colony of Vilnius Academy of Arts (in 2014 and 2016). Allgaier created a golf course, albeit without any holes. In an interview he gave to curator Sophie Lapalu, Allgaier explains: “I think golf and golf courses are symbols of our time. A way to privatize land. I like the story how Castro and Guevara played a round of golf to make fun of Eisenhower. When I first moved to Yokohama in Japan I was checking my address on google maps and I saw a lot of green and I thought, wow, so many parks. After moving there I found out most of them are golf courses, I was really disappointed... Somehow the project was to liberate this simple act, hitting a ball with a stick, from all this symbolic baggage, re-installing the liberty of the individual to take something serious or not.”

Avi Lubin

Kurator / Curator

Avi Lubin është kurator i pavarur dhe shef i studimeve teorike në Programin e Studimeve Post-diplomike të Arteve të Bukura, në Kolegjin e Arteve Hamidrasha. Ai është bashkë-redaktor themelues i Tohu, një publikim i pavarur i artit online në tre gjuhë (publikohet në gjuhën hebraike, arabe dhe angleze).

Punët e tij të kurimit përfshijnë ekspozita personale dhe grupe, në mesin e tyre Shkolla e Artit në Muzeun e Artit në Tel Aviv (Pavijoni Helena Rubinstein); Kohët e Errëta në Galerinë e Artit të Univeristetit Schreiber, Universiteti Tel Aviv; Pasagjeri i Fshehur në Apexart, Nju Jork; Lëvizjet Rrethore në Kunstverein Kunsthhaus, Potsdam; Gjurmë dhe Entropi në Studiot Artistët', Jerusalem, Paradoksi i Gjyshit në Galerinë Chelouche, Tel Aviv; Projektet e Artit ON-OFF, Hamburg; Themelet në Sommer Contemporary, Tel Aviv; dhe Fundi i Historisë në Künstlerhaus Speckstraße dhe Kutscherhäuser, Hamburg.

Avi Lubin is an independent curator and head of the theory studies at the Post-graduate Fine Art Program, Hamidrasha College of Art. He is the founding co-editor of Tohu, a trilingual independent online art publication (published in Hebrew, Arabic and English).

His curating work includes solo and group shows, among them Art School at the Tel Aviv Museum of Art (The Helena Rubinstein Pavilion); Dark Times at The Schreiber University Art Gallery, Tel Aviv University; The Hidden Passengers at apexart, New York; Circular Movements at Kunstverein Kunsthau Potsdam; Vestige and Entropy at The Artists' Studios, Jerusalem; Grandfather Paradox at Chelouche Gallery, Tel Aviv; ON-OFF Art Projects, Hamburg; Groundwork at Sommer Contemporary, Tel Aviv; and The End of History at Künstlerhaus Speckstraße and Kutscherhäuser, Hamburg.





























Albert Allgaier

Artist pjesëmarrës / Participating artist

Albert Allgaier, i lindur në Bregenz (Austri), ka studiuar Poezi Konkrete (具体詩) në Yokohama Shiritsu Daigaku dhe në Shkollën e Dizajnit Hong Kong dhe Studime Japoneze në Universitetin e Vjenës. Ai është bashkë-financues i GRUPPE UNO WIEN. Kurator i Bienales Bregenz 2012, 2014, 2016 dhe 2018. Ëndrra e tij është ta hapë një Qebaptore në Stamboll.

—

Albert Allgaier, born in Bregenz (Austria), studied Concrete Poetry (具体詩) at the Yokohama Shiritsu Daigaku and the Hong Kong School of Design and Japanese Studies at the University of Vienna. Co-Founder of GRUPPE UNO WIEN. Curator of the Bregenz Biennale 2012, 2014, 2016 and 2018. His dream is to open a Kebap Shop in Istanbul.












PYŎNG YANG



PYŎNG YANG









Gazmend Ejupi

Artist pjesëmarrës / Participating artist

Praktika e tij është fokusuar në identitetet e ngatërruara sociale dhe në kulturën e migrimit. Mediumi i tij kryesor është filmi; ai përdor kamerë dore, intervista të drejtpërdrejta dhe xhirime të paedituara për të arritur tregim të thjeshtë dhe bindës duke i theksuar vëzhgimet e tij të mprehta sociale. Më parë veprat e tij e kanë hetuar pamundësinë e ndarjes së artit nga jeta dhe faktin se duke e bërë këtë kontribuon në formësimin e vizionit tonë ndaj shoqërisë.

—

His practice focuses on socially conflicted identities and the culture of migration. His main medium is film; he uses a handheld camera, direct interviews and raw footage to achieve a simple, compelling narrative highlighting his astute social observations. Previously his work has investigated the impossibility of separating art from life and how doing so contributes to the shaping of our vision of society.



















Luan Bajraktari

Artist pjesëmarrës / Participating artist

Luan Bajraktari, është artist nga Kosova, i cili jeton në Vjenë. Pasi studioi për Skulpturë në Prishtinë ai shkoi në Itali ku vazhdoi studimet në Akademinë e Arteve të Bukura në Perugia. Veprat e Luan Bajraktarit koncentrohen kryesisht në zhvillimin e laboratorit kreativ të përditshmërisë, me gjërat që i takojnë asaj. Praktika e tij artikullohet përmes veprimeve shoqërore në formë të qeramikës, skulpturës, vizatimeve dhe instalimeve ku koncepti është qendror.

—

He is an artist from Kosovo, who lives in Vienna. After studying Sculpture in Prishtina he moved to Italy where he continues to study in Academy of Fine Arts in Perugia. The Work of Luan Bajraktari is mostly concentrated in developing a creative laboratory of the daily, with things that belong to it. His practice is articulated through social actions in the form of ceramics, sculptures, drawings and installations where the concept is central.
















Driton Selmani

Artist pjesëmarrës / Participating artist

Driton Selmani (1987) jeton dhe punon në Prishtinë dhe Doganaj. Ai studioi në Universitetin AAB në Prishtinë dhe studimet master në Artet e Bukura në Universitetin e Arteve në Bournemouth, MB. Selmani i qaset idesë së realitetit të perceptuar duke i dekonstruktuar formacionet e temave shoqërore, politike dhe kulturore të cilat janë mishëruar përreth tij. Në moshë të re i është kërkuar ta adhurojë një shtet i cili nuk ekzistonte më, gjë që ka ndikuar në formimin e një baze skepticismi ndaj çfarëdo realiteti të supozuar që i ofrohet. Më vonë, ai e përdori këtë si mjet përfitues për t'i rindërtuar besimet e tij në vepra vizuale të artit. Në vitin 1999, imazhet e vjetra janë zëvendësuar me imazhet e reja; ornamentet e hapësirës paraprake janë përtërirë në mënyrë që të shpalosen me kuptime të reja por gjithashtu me pasiguri të reja. Selmani e konfronton veten si spektator i kësaj “ngjarje në vazhdimësi”, por më parë e pozicionon veten si aktor, duke e luajtur performancën e tij të bazuar në historitë, besimet dhe dyshimet e tij personale.

—

Driton Selmani (b. 1987) lives and works in Prishtina and Doganaj. He studied at the AAB University in Prishtina and MA Fine Arts at The Arts University Bournemouth UK. Selmani approaches the idea of perceived reality by deconstructing formations of social, political and cultural topics that have been embodied around him. At a young age, he was told to worship a country that no longer existed, which caused him to form a basis of skepticism towards any supposedly given reality. He later used this as a beneficial tool to reconstruct his beliefs into visual artefacts. In 1999, old simulacra have been replaced by new simulacra; the ornaments of a previous space have been refurbished in order to unfold with new meanings but also new uncertainties. Selmani confronts himself as a spectator of this “on-going event”, and positions himself as an actor, enacting his performances based on his personal histories, beliefs and doubts.

























Fatmir Mustafa - Karlo

Artist pjesëmarrës / Participating artist

Fatmir Mustafa - Karlo (1984, Konjare) është artist nga Kosova. Ai studioi në Akademinë e Arteve në Prishtinë dhe i përfundoi studimet master në Universitetin e Arteve Helsinki, Kuvataideakatemia, Departamenti i Skulpturës. Vepra e tij kërkon të futet në paradokset sociale dhe politike të cilat ndodhin në vendin ku ai jeton. Ai gjithnjë vë në pyetje dhe konfronton, shpesh herë sfidon atë që konsiderohet si e ditur.

—

Fatmir Mustafa - Karlo (b. 1984, Konjare) is an artist from Kosovo. He studied in the Art Academy of Prishtina and completed his MA at University of Arts Helsinki, Kuvataideakatemia, Department of Sculpture. His work seeks to penetrate into the social and political paradoxes that occur within the locality where he lives. Forever questioning and confronting, he frequently challenges what is considered as the most obvious.















ISBN 978-9951-587-81-5



